

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME NUHI BYTYQIN

Prizren | Data: 3 gusht, 2022

Kohëzgjatja: 71 minuta

Të pranishëm:

- Nuhi Bytyqi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)
- Hidajete Osmani Bytyqi (E pranishme)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen.

Nuhi Bytyqi: Unë jam Nuhi Bytyqi i lindur me 11 mars, 1954 në fshatin Semetishtë në afërsi të Suharekës. Kurse dikur në vitin 1957 jemi shpërngulë prej atjehit edhe kem kalu në Prizren. Kemi jetu ni kohë të gjatë në Prizren, pothuajse deri në vitin '70. Prej vitit '70 pastaj kemi kalu këtu. Ishte iniciativa e babës me u tërhjekë edhe prej katunit, sepse ai në atë kohë ishte pak ma i shkollum se shumica e gjeneratës tij edhe ka punu në Suharekë. Por kërkesa e madhe për punëtorë të vyer në atë kohë edhe detyrohet me kalu në Prizren. Por, në Prizren, merre me mend ka pasë punën, ka punu në KEK edhe thuajse, s'e di a i ka pasë 300 metra rrugë deri te shpija.

Ai u detyru me e shitë shtëpinë, vet mos me qëndru me ni lagje, ka qenë shumë e keqe aty në atë pjesën ku kemi jetu, ka pasë njerëz të përzimë, raca të ndryshme. Mos të them raca të ndryshme, por nacionalitete të ndryshme. Ai nga frika se mos po degjenerohemi ne u detyru me ardhë në, me u vendosë këtu në Arbanë. Por, në Arbanë mirë kemi kalu. Unë shkollën fillore e kom kry në Prizren e shkollën e mesme po ashtu në Prizren. Në atë kohë kur unë e kom kry shkollën fillore, thuajse në Prizren ne si familje kemi pasë të partë në atë lagje televizor. Edhe përcillnim nga pak televizorin, tuboheshim fëmijtë e lagjës aty. Por, në ndërkohë edhe përcillnim nga pak radion, në mënyrë tinzare. Pothuajse të gjitha ato kanë ndiku te unë që pastaj pak të qëndrohem, mos të them, në zhargonin politik i themi revolucionar e të parahatshëm.

Në atë kohë, '67-'68 unë gjithmonë kom pasë polemika me ni pjesë të gjeneratave të vjetra, sepse ata mbronin politikën e Titos. Kurse ne fillum nifarë lloj averzioni ndaj Titos edhe kundërshtoja në atë kohë. Bile më kujtohet ishte ni plak i Koriçit nga, mos të them, arroganca ime por entuziazmi im po i thotë babës, tha, "Këtë djalë ki me pasë të parahatshëm". Edhe vërtetë nuk shkoi kohë e gjatë unë fillova të kem nifarë bindje në vete, fillova pak të angazhohem ma tepër politikisht. Edhe pse isha në studime, u angazhum me shoqni, zhvillonim propagandë të ndryshme kundër regjimit Titist, por ende s'kishin marrë hov në atë kohë ngjarjet.

Anita Susuri: A keni qenë i organizum a veç vet prej...

Nuhi Bytyqi: Na vetvetiu kështu kundërshtonim politikën e tyre, se të tregova që ne kemi përcjellë në mënyrë tinzare televizionin e Shqipnisë. Thuajse, ai televizion neve na ka inspirue që ne pastaj ta duam Shqipërinë. Në atë kohë ta duam edhe xhaxhin [Enver], por ka qenë koha për me dashtë në atë kohë. Kështu që, filloi ai inspirimi kombëtar edhe unë me disa nga shoktë e mi u angazhova vet, në

mënyrë spontane të themi edhe vazhdova karrieren, them, politikisht. I ndërpreva studimet edhe u angazhova andej.

Anita Susuri: E ju në studime keni qenë në Prishtinë apo?

Nuhi Bytyqi: Po, Fakultetin Ekonomik.

Anita Susuri: E qysh ka qenë, për shembull, për juve si student në atë kohë, qysh keni jetu si student?

Nuhi Bytyqi: Unë jom marrë kah pak me poezi edhe falenderoj gazdën tim paraprakisht ka marrë nifare lloj informate që po zhvillojmë një propagandë anti Tito edhe ma tërhoq vërejtjen. I grisa të gjitha ato shënime që i kisha, ato poezi, edhe ia dhashë fjalën thashë që, “Ma nuk do të ketë problem nga ana ime”. Fillova të tërhiqem prej tij mos të kem... edhe të mos e fus atë në telashe, por edhe vetën që të mos bi ma shpejt në grackë.

Në ‘79-tën u burgosen disa nga shoktë tanë, bile nja dy janë të Prizrenit, e unë arrita me u shmangë atyre ngjarjeve, por nuk shkoi gjatë pastaj fillunë edhe ngjarjet tjera, që mos të them që i kemi parapri apo që i kemi ditë, po ngjarjet e ‘68-tës i kanë dhanë një stimulus dhe ngjarjeve të mavonshme të ‘81-tës. Po nuk kemi pushu ne, në mënyrën tonë kemi veprue, në mënyrë ilegale, duke propagandue kundër politikës jugosllave edhe për një shtet që duhet ta kemi edhe ne shqiptarët.

Anita Susuri: E jeta që e patët në Prishtinë si person ma... si me thonë student, pra që jeni përpjekë me bo aktivitet për me vetëdijësu popullin për pozitën e shqiptarëve. E qysh ka vazhdu jeta në shoqëri për shembull? Çfarë angazhime ka pasë, edhe kulturore, sociale gjatë viteve të studimeve?

Nuhi Bytyqi: Po ne nuk guxonim në atë kohë me u eksponue, me dalë publikisht në atë formë, po kishte, ekzistonin mënyra të ndryshme të afrimit të shokëve. Ishte fillim-faza kur duhej zbulu shoqnia, cilët ishin ata që ne kishim besim edhe mund të vazhdonim ma tutje, edhe cilët ishin ata që ishin me politikë jugosllave e që ne duhet të shmangeshim prej tyre, se ishte rrezik në atë kohë. Po nuk kemi ndërpre, kemi vazhdue, kemi propagandue. Edhe në çerdhen e studentëve aty, ka pasë kundërthanie të ndryshme, dikush ka përkrahë politikën Titiste, ne disa kemi qenë kundër asaj politike, por ka vazhdu jeta.

Më kujtohet mue si student në fillozofi më ra një pyetje informbyroja edhe aty ekziston një thanie se, Titoja thotë, “Duhet të ecmi rrugës drejtë, e jo të shërbehemi me gënjeshtër.” Thashë, “Profesor be”, thashë, “çdo mëngjes baba më ka thanë duhet me ecë rrugës drejtë e jo të shtremtë”. Tha, “Ti po tallesh a?” Thashë, “Jo, a o e vërtetë”. Ajo ishte ma se e vërtetë se edhe atij i ka thanë baba vet që duhet me ecë rrugës drejtë. Edhe um përzuni prej sallës, “Notë kaluese, por shporru”, tha. U vërejt aty njëfarë refleksi im, por përsëri duhej ne të rezervoheshim, sepse po them nuk kemi qenë bash të bindun se do të ndodhë diçka.

Por, ja që ndodhën ngjarjet e ‘81-shit edhe ne u gëzum, u gëzum pa masë, sepse na u dha mundësia për me vepru pak ma sh lirë. Edhe prej atij momenti, pastaj nuk kanë pushue aktivitetet, mënyra të ndryshme. Unë thashë, i ndërpreva thujse tërësisht studimet, u përcaktova me shoqni. Formuam një grup, atëhere është qujt KOMKOS-ët që do të thotë komunistët kosovarë, me motivacion se do të arrijmë t’i realizojmë dëshirat tona, kërkesat tona për një shtet tonë.

Anita Susuri: E ky grup ka qenë si i pavarësum, jo me llegalen ose diçka? Qysh...

Nuhi Bytyqi: Jo, na kemi qenë grup në veçanti. Une nuk jam pajtue fillimisht me punën e grupeve llegalë. Drejt me thanë, unë kam qenë pak ma i hapur, sepse mendimet e mija i shprehsha shpesh, kërkoja, kërkoja që duhet me dalë publikisht edhe me kërku diçka. Edhe kështu që e formuam grupin, kemi arritë përmes trakteve të ndryshme, sepse unë e kom pase edhe maqinen e shkrimit edhe e shkruajshim vet, e përpilojshim me Azem Ramadanin edhe me Fazli Memaj, i cili tani gjendet në Gjermani. Kurse me Azemin përpilojshim tekstin edhe i shkruajshim. Une vet i shkruajsha edhe i shpeshim nëpër pjesë të ndryshme në qytet.

Anita Susuri: E këtë makinën qysh e keni rezervu?

Nuhi Bytyqi: E kemi pasë, unë e kam pasë në atë kohë. Baba ka qenë, kontist, nëse e kupton në ekonomi. Ka punu në shërbimin e kontabilitetit edhe aty ma ka siguruar ai maqinen vet prej tyre, e kom pasë unë maqinen edhe kom shkrujt ka pak. Qetu ka qenë një tabelë {bën me shenjë në anën e djathtë} e madhe edhe në atë kohë unë bile e pata shkru një trakt, një parullë të them. Si të zgjohemi nga gjumi, ka ardhë momenti për me u zgjue, edhe u rrethunë policia, u tubun aty, u bë grumbull, edhe unë po afrohem, p’e shoh grumbull, po bohem kishe s’po di çka ka ndodhë.

Nji moshatar imi i lagjes, unë e pata provokue, thash “A po e shkrun ti [parullën] e une p’e vendosi [pankarten]? Apo ti shkruje domethone une e shkruj ti vendose ose ti shkruje une p’e vendosi”. Ai nuk pranoi asnjërin nga variantat. U detyrova une me shkru. Ai më vrejti aty, a tha, “Kush e ka shkru, e hantë...” më fal në shprehje [i drejtohet intervistueses]. Edhe po, nuk ka tregu ai, po mua më tha se e di që unë e kisha shkru. Edhe p’e kqyri, unë si me ironi atë. Edhe bënë bujë të madhe për një parullë, ça ishte ajo parullë, “Duam shtetin tonë e jo nën Jugosllavi”. Po kaloi ajo.

Pastaj ne... edhe djali vllaut tim ka qenë shumë aktiv. Ai ka qenë pak ma i ri në moshë, ai shkrunte natën. E rruga ishte krejt laramani, kisha frikë sepse vinin ka une andej. Nji moment unë e kisha kry aksionin tim, kisha bë shpërndarjen e pamfletëve natën edhe ata po vinë. Po më shohin, edhe unë, e kemi pasë njëfarë burimi edhe unë po e pastroj ftyrën, e po kalojnë policia kolonë. “Mirëmëngjesi!” “Mirëmëngjesi!” U befasova, “A ki punu ton natën a?” Thashë, “Po, po”. Po shkun, se i lypshin shenjat ka është shku ngjyra. Ai djali vllavit kishte ikë ktu pari edhe ka dalë atje. Po kaloi ajo, ai moment.

Pastaj ne, parreshtur kemi vazhdu aktivitetin tonë me Azemin. Edhe erdh momenti kur ne u zumë, ramë në burg, nuk kundërshtum. E kishin zanë një nga shokët tanë në aksion, edhe ai s’ka mujtë m’u përmbajtë, dhe mu më erdhën policia më murën në mëngjes herët. Ku e kanë ditë, interesant ka qenë ai moment, se direkt e në dhomë time kanë ardhë. Edhe në shtratin tim, jo të vllaut, po shtratin tim. Thotë, “Hajde zgjohu Nuhi”. U zgjova. Nana ishte pak e dobtë ka shëndeti, gjyshja, një hallë, baba, u trazunë të gjithë, edhe unë s’po boj zo, u vesha edhe po qëndroj qeshtu {tregon duart të kryqëzuara} me një kand të dhomës, nën përcjelljen e tyre, nën vëzhgimin e policisë.

Ata bojshin kontrollë, pastaj lypshin material. Unë s’kisha material, sepse e kisha shpërnda, të tërin e kisha shpërnda, s’kisha lënë asgjë. Po kanë marrë do fotografi e... letra çka kanë gjetë ashtu, vjersha edhe më dërgun në burg. Më dërgun në burg atje, pastaj aty fillunë maltretimet. Unë të drejtën me të thanë, e kam pasë një kojshi, gjykatës hetues, Skender Berisha. E kemi pasë vërtetë fqinjin e parë në

Prizren. Po kërkon ai nga une që une të tërhiqem edhe të dalë nga aty, të pendohem. Ma dha një cigare, tha, “Edhe mos e thuj fjalën e fundit”, tha, “të parën”. “A fillojmë, fillojmë”. Daktilografistja...

Anita Susuri: Në Prizren a po?

Nuhi Bytyqi: Prizren, Prizren. Daktilografistja aty {bën me dorë sikur shkruan} edhe po thotë, “Fillojmë Nuhi”. Thashë, “Unë nuk e ndiej veten fajtor, plotësisht jam i vetëdijshëm për veprën që e kom bo”. “Ndale ndale”, po thotë, “ndale këtu”, {bën me dorë shenjën ndal} “ndalu këtu”, po thotë. Edhe po i thotë asaj, që ndalu edhe ti, mos shkruaj. Tha, “Nuhi u morëm vesh që mos e thuj fjalën e fundit të parën. A vazhdojmë?” Thashë, “Vazhdojmë”. Unë po i them përsëri të njejtat tash. Une thashë, “Nuk pendohem për veprimtarinë time që e kam bo, edhe plotësisht jam i vetëdijshëm për veprën që e kam bo”. “O ndale”, tha, “ndale pak”, ndalu. Edhe drejtë me thanë, e ka ndërprejë atë seancë, e ka ndërprejë, se u dukte me marrë deklaratën.

Edhe me mendim që, i thirri ata gardianët e burgut edhe më çunë në dhomë në burg. Edhe ka shku i ka thanë babës, “Smajl, shko”, thotë “bisedo me Nuhiun”, thotë “që të tërhiqet”. Më erdh baba edhe më lanë mua në vizitë qëllimisht tash që domethonë me u pendu në një mënyrë edhe me dalë prej burgut. Tha, “Shiqo be bir”, tha, “i ke bo do vjet, burri nuk pendohet”, tha, “për ato që e ke bo në mënyrë të vetëdijshme, s’ka tërheqje”. Ooo t’ia kanë ngjitur babës për kresh e te kanë qitë jashtë. E mua më kapën më çunë në dhomë. Pastaj i kanë tregu atij gjykatësit. E ai më mor në pyetje, tha, “Po më duket si ti, si baba, ju të njejtë. Po vazhdo çka ki me thanë”, tha, “nuk e kam ndërmend me të ndërpre”.

Edhe vazhdova unë, krejt deklaratën time, çka kisha bo e nuk ish problem se s’kisha nevojë me u pendue edhe mos me pranu veprën se na ishim për një kërkesë të tillë për një shtet. Kemi pasë malltretime, kemi pasë rrahje. Përsëri po them, jo vetëm gjykatësi, por edhe Astrit Koshi ka qenë fqinj i imi, diku në distancë prej 150 metrave, njëfeshim familjarisht, ai me më prekë jo. Po vishin serbtë edhe e shihshin që s’ka, s’po nxjerrë prej meje asgjë, se s’kisha nevojë unë, e kisha pranu veprën. Po tash, me shpikë emra të rinj, me shpikë emra të ri. Me shapulla prej një faqe, në faqen tjetër, prej një muri në mur tjetër. Po nejse, kalun ato.

Azem Ramadanin e kanë rrahë shumë, atë jashtëzakonisht tepër e kanë rrahë. Edhe pastaj vazhdun hetimet si tha edhe zoja ime, edhe natën ka pasë, në kohën kur ti mendoje se taman ke ra, do të qetësohesh edhe do të flen pak, nifarë pushimi, vike në derë ai. Thojke, “Hajde, zgjohu!” Nuk ish që kishte çka me mor mo shënime, po vetëm mos me leju me u qetësu ti si duhet. Edhe kalun ato momente, u afriu koha e gjykimit...

Anita Susuri: Sa keni qenë në hetime?

Nuhi Bytyqi: Diku një muj e gjysmë, sepse të gjithë ne e kishim pranu veprën, nuk kish aty problem. Po neve si grup na i bashkangjiten një grup tjetër të Arbanës, që edhe ata ishin mor me... vërtetë edhe me shkruarjen e parullave, se të njejtës lagje. Na i bashkangjiten edhe na dënuan. Neli pat arritë me ikë, Fazli Memaj, ai u tërhoq, shkoi në Gjermani e na tjerët mbetëm në burg.

Anita Susuri: Ka ikë prej burgut a?

Nuhi Bytyqi: Jo, para kohe. Ka marrë informata që ne jemi të arrestum edhe ai...

Anita Susuri: Ka dalë ilegalisht?

Nuhi Bytyqi: Po, ka ikë. E na u dënum pastaj. Une u dënova shtatë vjet nga Gjykata e Qarkut, Azemi pesë vjet, shokët tjerë dikush tre, dikush dy, dikush një. Po, aty në dhomë ku kemi qenë në burg, na kemi kalu shumë mirë. Këndonim këngë, unë s'kisha zë, po të tjerët kishin, këndonin bukur. Kur dilshim në shëtitore, e kemi pasë, se burgu edhe ndërtesa e Sigurimit kanë qenë përballë. E ne në shëtitore dilshim edhe e ngritshim kmishën lart edhe i mshonim barkut: "Republikë, Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!" E ata prej inatit dilshin në dritare, "Shtini mrena këta idiota". Neve na shtishin mrena, ata, disa nga gardianët që ishin të arsyeshëm, "Mos boni problem be, se po duhet me ju shti mrenda, e s'po kemi dëshirë. Mos krijoni, se vetes po ia boni". Po ishte motoja jonë për me i nervozue ata të Sigurimit, mos me i leju të qetë me qenë. Ky ishte qëllimi ynë.

Anita Susuri: A keni qenë këtu në Prizren në burg?

Nuhi Bytyqi: Po, po, po në Prizren, deri në momentin kur na kanë transferue, na kanë çue në një burg ma famëkeq në Jugosllavi. Kanë ardhë natën na kanë marrë, na kanë dërgu në Prishtinë, prej Prishtinës aty, në mënyrë të organizume me një kamion të mbyllur. Aty, merre me mend diku nja katër, tre-katërdhjetë vetë, ngushtë, tym, Me nerë me thanë s'kishim nevojën ku me bo, nëpër shishe qashtu, turpi i Zotit. Na kanë lidhë, na kanë çue në Beograd. Në Beograd ne kemi qenë të lidhun, domethënë nga dy vetë, e tash në Burgun Qendror të Beogradit, kishim nevojë na me shku ka pak në banjo.

Merre me mend, shoku u duke me qenë përpara, e dikush tjetër m'i kry ato nevojat. Po, turpi Zotit, po ja, kështu i kemi përjetue ato, deri kur na kanë dërgu në Gospiq. Po e them Gospiqi ka qenë burgu ma famëkeq në Jugosllavi në atë kohë, sepse diku në '42-tën, '43-tën thojnë, ai burg ka qenë i shkatërrur. Ne kemi qenë diku në katin e tretë, domethënë prej '43-tës e deri në '82-tën s'ka pasë, ai ka qenë i mbyllur ai kat. Na e kemi, për neve e kanë çelë atë objekt edhe neve na kanë shti mrena aty, në ato shtretër të moçme, të vjetra. Menzi i kanë gjetë do sungjera, na i kanë prue, na kanë vendosë qaty.

E aty të them të vërtetën, momenti kur, se unë kam arritë të jem... e kam pasë një djalë të ri, ka qenë diku 17-18 vjeç. Edhe ai ishte arrestu për parulla, merre me mend, pse ka shkru në dërrasë të zezë "KR Kosova Republikë". Pesë vjet i kishin dhanë djalit, edhe e mendojke tugu, e ishte një e çame e derës, e dy krive të derës, edhe aty u afrojke, merrke pak ajër. Edhe kur mrrimë aty, sepse ne s'kemi ditë ku po na çojnë, nuk e kemi ditë. Duke mendu se po na çojnë diku në Serbi, a din, 17 orë i bamë rrugë. Na zbritën aty, unë edhe ai ishim të parët edhe veç na kanë thanë "Vdishuni!" [zhvishuni] Domethonë, komplet jemi vdeshtë ne, ashtu si na ka bo nana.

Me rroba në kri [krahë] edhe në dy anët gardianë të renditur. Barkit, shpinës, kokës, këmbëve, trupit, ka kanë mujtë, me do farë asi kërbacha të mëdhej. Ka kanë mujtë edhe deri në organet gjenitale, domethënë kanë sjellë sa kanë mujtë. Na kanë vendosë nëpër dhoma, derisa janë vendosë krejt mrena. Ishte ma e keqja kur ti tash i vrejshe se të gjithë po rrahen. O nuk e beson, sepse na ishim dy, pastaj se ishin nga tre vetë në dhomë, u duhke edhe njo me pru. Kur e kanë prue atë të tretin, kishte qenë krejt gjak në pjesën e poshtme.

E kemi marrë e kemi qetësue edhe kemi kalu nja dy orë a tri derisa u qetësue situata. Ai tash me shku te mjeku, kinse një kontrollë. Teposhtë rrahje, te mjeku provokime, "Mos gaboni", thojke, "me rreh". Po

në anën tjetër i thojke, “Mshoni”, kumeditë. “Knej mo se keq o, e knej mshoni...” Edhe pastaj shkallëve përpetë, kamve, ka mujshin, trupit e përsëri në korridor, në dy anët gardianë. Po them, dhjetë me një anë, dhjetë me një anë edhe sillshin sa mujshin. Po, i kemi kalu ato. Nuk e kemi ditë ku jemi. Nuk e besoni ju se nuk e kemi ditë diku nga tre muj ku gjendemi.

As baba s’ka mujtë me ditë ku jemi sepse ka kërkuar nëpërmes hetuesisë e nëpërmes gjykatave, ku ka ardhë deri në Kroaci, deri thujase në vendin ku gjendemi ne, edhe i kanë thënë, “Jo, nuk janë këtu, në Serbi janë a ku janë”. U detyru baba me u kthi përsëri prej Kroacisë pa vizitë. Pastaj pas një tre muj a katër, thanë që mujtë me shkru nga një letër, po jo adresë. E kemi shkru nga një letër. Më beso, kisha harrue edhe emrat e familjarëve disa me i cekë. Kisha harrue, s’mu kujtojsin. Po, “Jemi mirë”, dhe pastaj fillunë me ardhë në vizitë kapak. Erdhi një vëlla, e ka pasë djalin e vet, ai që shkrunte parulla thashë, e ka pasë. Pastaj u zhdukë, ka ikë prej organeve të Sigurimit, si i ri ka dalë, ka depërtue në rrugë, ka hypë në autobus të Vërmicës edhe ka ikë, ka dalë në Shqipëri.

Ata e kërkojsin, këta këtu, edhe e kishin gjetë në Shqipëri. Erdh, po më lajmëron, po thotë “Nuhi, e gjetën Fatmirin”, si e ka dëgju, se i kishin thonë ata mos fol shqip, serbisht. Çka o ma e keqja, e kemi pasë një gardian, Agim, ata e thirrshin Pero domethonë Agim *zvani* [njihej si] Pero, edhe na s’e dishim që ishte Agim ai. S’na like me fol shqip. Si u prezentu, si më tha e kemi gjetë Fatmirin, e kanë marrë e kanë tërheqë, mu më kanë kthye, se më thanë me fol serbisht. Thashë, “Jo, jo, në mujsha m’u marrë vesh me mimika mirë, mos mufsha”, thashë, “nuk flasmi serbisht”. Na kthyn.

Pastaj fillunë ma në rregull me ardhë baba e aty-këtu, po nuk na mbajtën shumë. Diku nga gjashtë-shtatë muj edhe prej aty, se aty pastaj ne bëmë disa herë grevë, kërkuam të drejtat tona, sepse fillim me u liru edhe ne. Se ata mendonim që ne jemi njerëz të egjër. Nuk e dinin se ne ishim njerëz të butë, kërkojsim libra me lexue, vetëm libra thojshim, na bini libra me lexue, ne pastaj nuk ka problem. Po erdh ndërkohë jurisprudenca e Kroacisë, na intervistoi kështu nëpër dhoma, edhe nuk vonunë pastaj, na murën na çunë. E bëmë na një grevë aty, në mënyrë të organizime, që tha edhe zoja, me shenja [i referohet gruas së tij].

Si erdhën grupi tjetër nga Prizreni edhe ndash beso, ndash jo, se unë prej syve kam qenë, shumë mirë kam pa. Kurse një shok i ngjarjeve të 25 marsit në Prizren, Begzat Gashi, ai dëgjojke shumë mirë. Edhe po thotë, tha, “Kanë ardhë dy grupe nga Prizreni”, “Jo bre”, tha, “Për ner’ po dëgjoj zhurmën e të rrahurave”. Edhe kemi nisë “Republikë, Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!” {bën shenjën e grushtit si shënjë proteste}. Kanë kthi përgjegjen edhe kemi tregu me grrithje të murit ka sa vite jemi në burg, edhe mejherë e kemi konstatu, e kemi gjetë kush janë shokët. Po jo që ne u gëzum që erdhën ata aty, po me një mënyrë domethanë u shumum.

Pas një gjashtë-shtatë muje na largun prej aty. Pastaj na largun të zgjidhun, se u bindëm që mo s’ka të boj me njerëz të egjër. Na kanë çue në Lepogllavë. Lepogllava ka qenë tipi pak ma i hapun [i burgun], por mrenda mureve. Aty në Lepogllavë ka qenë burg, po ka qenë një po e them një uzinë e madhe. Aty ka pasë të burgosur shumë, po edhe kanë qenë të detyrum me punue. Domethanë, kanë qenë shumë reparte, kanë pru njerëz, s’i kanë lanë me nejtë, kanë organizue, na kanë sistemu nëpër dhoma.

A ka pasë kriminela, a ka pasë hajna, ata s’e kanë pasë atë dert, po na kanë vendosë [bashkë]. Aty më erdhi mu informata, se pastaj prej shtatë vjetëve isha zbritë në pesë vjet. Derisa une i numërojsha shtatë vjet me ditë, se ne si të burgosurit, i numërojshim ditët sa, tash zbritën 700 ditë, zbritën. Edhe

thashë vet me veti, thashë ja ku mrrina, thashë edhe katër vite. Po, shiqo, kur të kije shok të mirë, intelektualë të mirë, ne kemi kalu një jetë shumë të mirë në burg.

Kemi pasë maltretime, ne kemi qëndru nëntë ditë në grevë, vetëm pse e kanë rrahë një nga shokët tanë. Nëntë ditë pa ngranë hiç, asnjë kafshore bukë. Mas nëntë dite, kinse u realizun disa prej kërkesave tona, po disa nga shokët tanë ishin transferu në burgje tjera e neve disave na lanë aty. Por [kishim] njëfarë lirie pak me komunikim mes veti, me qëndru gjatë, po mendoj mas orarit të punës, jo gjatë orarit të punës se e ki pasë të kufizime. Uleshim në oborr, bisedonim, komunikonim, lujshim, hajgare, pak aktivitet sportiv, kështuëqë ka kalu koha. Po ka pasë edhe momente kur kemi qenë edhe, kemi bo edhe na vet probleme nganjëherë.

Na imponojke statusi ynë me bo probleme pak, a po kupton? Na imponojke vet kauza jonë me bo, me kriju kapak probleme, me qëndru të palëkundun. Ishte momenti kur duhej na m'u zgju në... Titoja ka pasë ditëlindjen edhe tash u duket m'u ngritë të gjithë në këmbë. Na shqiptarët asnjë s'jemi ngritë në këmbë. Erdh, na i murën informtatat, pastaj më dënnun me qeli [vetmi], po jo vetëm mu, po edhe tjerë, po edhe shumë herë na dërgonin nëpër vetmi. Kishte momente kur thujase, nganjëherë krijonim problem për qefi, vetëm m'i marrë librat në sjetull edhe me shku me lexu kapak në qeli atje, deri kur e kuptun.

Më beso, e kuptun që qëllimisht po duam me shku në vetmi, e tha, "Jo", tha, "në vetmi, nuk po shkon në vetmi", tha, "pra. Ke me u kthy", tha, "në repart tjetër". Ma ndërroi repartin, po nuk më çoi në vetmi. Po them, diku nja gjashtë-shtatë herë kam qenë gjatë asaj periudhe në vetmi, po nuk e kemi pasë brengë, se kemi pasë na momente edhe ma të vështira të torturave. Ato në Gospiq, janë të paharrueshme shka kemi përjetu ne.

Anita Susuri: Dhomat e vetmisë a kanë qenë ma të vogla, a kanë qenë me dritare?

Nuhi Bytyqi: Ma të vogla kanë qenë, ma të vogla, kanë pasë dritare, po nuk ki pasë këpuca ti, [i ke pasë] pa lidhëse, pantollat kanë qenë të mëdhaja, këmishat. Domethanë, kanë mujtë mos me të ra taman, u dashtë me i majtë në dorë e këpucat pa lidhëse. Të qitshin ka pak në shëtitore, ka dhjetë minuta të kthejshin mrena. Por nuk ishte ajo brengë, pse ne qëndronim në vetmi, jo, jo. Po kjo ishte faza e parë kur unë e përfundova burgun, erdha në shtëpi.

Anita Susuri: A e kanë ditë familja që ju kanë zvogëlu [dënimin], sigurisht?

Nuhi Bytyqi: Po, po, po, po, se vazhdun pastaj vizitat. Po, vazhdun vizitat pak ma në mënyrë të rregullt. Vishin në vizitë, kontaktonim me prind. Kanë ardhë baba shpesh herë, motra, vëllau, vishin, na sillshin ka pak ushqim. Meqenëse s'kishim nevojë ne për ushqim atje, sepse në burgun ku kemi qenë ne, ka qenë vuajtje e dënimin edhe, Josip Broz Tito e kish pasë lanë me gojë pastaj në periudhë kur është emëru kryetar, që të burgosurit me pasë të drejtë me u ushqye mirë, domethanë, me i dhanë me ngranë mjaftueshëm. Mos me pasë mo sikur në Prizren apo në Gospiq që e kemi pasë të caktume sa domethanë.

Anita Susuri: Ku ka qenë ky burgu, Titoja ku ka qenë?

Nuhi Bytyqi: Në Lepogllavë.

Anita Susuri: Aha.

Nuhi Bytyqi: Në Lepogllavë. Edhe atje, thashë e kemi pasë ushqimin e mirë, nuk ka pasë problem. Kemi kalu mirë. E krewa dënimin dhe faza e parë e jetës sime ishte kjo, që unë e përfundova atë periudhë.

Anita Susuri: Cili vit po i bjen që keni dalë prej burgut?

Nuhi Bytyqi: '86-tën, në fund të '86-tës. Pata fatin, u njoftova me shoqen e idealit, edhe u martuam. Po i parahatshëm edhe unë, ajo ka qenë thujase ma e parahtshme ideologjikisht. Po mu fillunë, më angazhoi shoqnia, hajde se duhet formu diçka, mos me qëndru kështu. U angazhova unë pak në tregti që m'i ikë pak politikës edhe pak çështja familjare, se u martova unë, duhej me kriju të ardhura.

Anita Susuri: Pra, nuk mujtët me...

Nuhi Bytyqi: Jo, e lashë, thashë, se gati e përfundova gati atë karrierë edhe vazhdova nga pak me punue. Po përsëri, të parahatshëm ne. Ai vrulli {e prek mesin e gjoksit}, kauza nuk na linte të qetë, edhe forum përsëri një grup, tani me pretendime për luftë. Bile një nga mbledhjet konstituive është mbajtur edhe në shtëpinë time. Ekzistojnë raportet e grupit atje, po ato i kanë marrë Sigurimi i atëhershëm. [Në vitin] '90-'91, i kanë marrë shënimet edhe une s'kom arriturë ma m'i përvetësu ato shënime edhe m'i pasë në dorë. Data kur është mbajtur, ma e keqja data kur është mbajtur, a din, s'kom arriturë m'i shënu ato.

Pastaj janë mbajtur edhe mbledhje tjera në Prizren, në Nashec, në Vvri. U formu grupi, po ka qenë fati tjetër që prej Prizrenit vetëm une jam dënu edhe Naim Krasniqi. Tjerët, është ndërpre lidhja edhe s'kanë pasë [dëshmi]. Dikush ka ikë, dikush jashtë, dikush këtu mrena në ilegalitet, kështu që nuk kanë ardhë në burg. Gjakova kanë qenë një grup i madh, diku prej 14 vetëve. 13 kanë qenë të Gjakovës, dy të Prizrenit, një i Suharekës, një i Mitrovicës, një i Prishtinës. Domethanë, kemi qenë 19. Grupi 19 thirret edhe grupi i Gjakovës në krye me Mentor Kaçin. Prej Prizrenit na kanë çue në Pejë, aty kemi qenë të stacionum, deri sa është mbajtur gjykimi.

Domethanë, ka zgjatë procedura hetimore diku dhjetë muj. Pra, gjatë asaj periudhe dhjetë mujore në Burgun e Pejës nuk ka pasë maltretime, sepse ka ekzistuar metoda ma e mirë për me zbulu a p'e tregon të vërtetën apo po gënjen. Nëpërmes atyne metodave domethanë kanë arriturë neve me na zbulu që çka, ku qëndron e vërteta edhe çfarë po mshefim

Anita Susuri: Si ke edhe niherë viti, herën e dytë që jeni...

Nuhi Bytyqi: '90-'91 ka qenë periudha kohore, po. Edhe aty, unë pastaj, si grup ne u dënum dy vjet, sepse nuk kish ma vepër time për me u dënu, po si përsëritës. Domethanë, mua më dënum dy vjet, pastaj në gjykim neve na lirunë. Çka është ma interesant, se në Pejë ka ardhë në vizitë, merre me mend ka qenë gardian shqiptar edhe e ka prue çikën në vizitë, nuk ma kanë lejue, por kjo s'më pati tregue mue hiç. Se me pasë tregue, ndoshta kisha kriju problem, se na nuk i pritojshim me bo probleme në burg. Jo në favor timin, po që me bo problem pse mos me lejue për shembull, me të leju vizitë.

Në atë kohë kemi kaluar atë periudhë edhe ne arritëm me dalë, përsëri me u mbrojtë në liri, një tre a katër vetë që ishim nga dy vite [të dënuar]. Domethanë, dhjetë muj i kisha mbajtur, tash 14 muj çka vendosë Gjykata Supreme. Për fat të keq, Gjykata Supreme mas një dy-tri vjete, në '95-tën erdh vendimi që o plotfuqizue. Domethanë, 14 muj duhet m'i mbajtur. Nuk kam tentu me ikë, e kom ditë që dy vjet do t'i kem burg, edhe 14 muj. Kanë ardhë policia, më kanë lyp, s'ma kanë gjetë shpijën. Po më vinë rinia, po më thonë, "O baci Nuh, po të lypin policia". Thashë, "Ja këtu jam". Ja qatë përballë isha [bën me gisht nga ana e djathtë].

Punoja nga pak tregti. Edhe kur erdhën policia, po më thojnë serbisht "*Jel duguješ nešto? A ke borxh diçka?*" E rrudha gojën [ngritë supet]. Më murën mu më dërgun në Sekretariat. Atje me... ka pasë maltretime psikike shumë të mëdhaja, për familje sidomos, se për veti më s'kisha problem, po për familje. Po mas një tri-katër ore Zenel Kabashi, s'e di, ai veteran, edhe ai ka qenë i burgosur, domethanë i kësaj grupës nacionale, si ballista. Ka qenë edhe ai i papërmisushëm, armik i madh për ta.

Me të bashkë, në qatë farë çka i thojnë furgona, që po ju thojnë këta, na çunë në Pejë. Aty kemi qëndru një dy javë ditë në, i thojnë karantinë, para se me kalu në tipin e hapur të burgut. Jo tipi i hapur, tipi i hapur ishte ata që qëndronin jashtë, po pak ma ndryshe. Domethanë, ki oborr me dalë me shëtitë, m'u angazhu pak, aktivitet fizik. Po, pastaj kalova aty, një kohë të gjatë kom qenë me Ukshin Hotin, gjashtë muj ditë kam qenë me to në dhomë. Një periudhë kohore kam qenë me Haxhi Feratin, s'e di a jeni taku ju me të. Edhe ai është grupi i këtyre, i Qeverisë të [Ministrit së] Mbrojtjes.

Kanë qenë ata një grup intelektualësh që janë burgosë në atë kohë, pa dashtë as m'u mundu m'u angazhue në front. Por, jonë arrestue edhe kanë qenë në vuajtje të dënimit. Ai është profesor, doktor profesor Haxhi Ferati. Ukshin Hotin veç e dini. Por, kom pasë fatin me qenë edhe me shumë shokë tjerë, intelektualë, që kemi kaluar momente të mira. Pas 14 muajsh vuajtje të dënimit, unë u lirova edhe nga ai. Po domethanë ishte hera e tretë që unë shkova përsëri në burg. I mbajta edhe ato 14 muj dhe arrita m'u kthi në shpi, arrita m'u kthi shpesh e mirë, pranë familjes sime. Krijum familje të mirë, kam tri vajza, një djalë, kam nipa, mbesa, po ma me rëndësi se e kam zonjën time taman për qefi tim.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po më intereson tash që e përmendët për grupin, për luftën, për zhvillimin e luftës. A ka pasë ndonjë lidhje me partinë e luftës ndoshta, të Adem Demaçit...

Nuhi Bytyqi: Jo, jo, jo. Po shiqo, çdo gja ka lidhshmëri, po na s'kemi pasë me ta kurgjo. Na grup i veçantë, ka qenë grupi i Gjakovës. Iniciativa ka qenë e tyne atëherë me u zgjeru, ka arritë rrjetin me e gjetë në Prizren, nëpërmes Prizrenit pastaj me ra deri te une në kontakt e me ra me shumë të tjerë. Edhe është arritë ai qëllim, sepse neve na e kanë zbulue kamionin me armë edhe me uniforme komplet në kufi të Maqedonisë. Kanë arritë me e konfisku atë material, po nëpërmes advokatëve janë lirue Naim Krasniqi, Mentor Kaçi. Ndërkohë, derisa ata kanë arritë me shku përsëri në Shqipëri, me organizue diçka, përsëri rreth armatimit t'u kthi për Kosovë janë arrestue. Edhe për fat të keq, pastaj kemi arritë me u arrestu të gjithë.

Është bo një rrjetë e madhe e grupit, tash prej 19 vetëve edhe që të gjithë kemi vujtë ka pak burg prej atyre 19-ve. Asnjo s'është lirë me dalë i pafajshëm. Po s'ishte qëllimi me dalë i pafajshëm, sepse ishte kauza me bo diçka për popull, m'i tregue serbëve që ne kemi një qëllim dhe ai qëllim duhet me u realizue. A deshët ju a s'deshët, na e kemi atë synim. U zunëm, vujtëm burg, po u lirim shëndoshë e mirë të gjithë kemi qenë.

Anita Susuri: Po du pak mrapa mu kthy se e tejkalum si shpejt. Demonstratat e '81-tës, përvoja e ju, çka keni pa, çka keni përjetu?

Nuhi Bytyqi: Shiqo, më 11 mars është ditëlindja ime, 11 mars. Tash, kur më kanë marrë në pyetje në hetuesi, "Kur je i lindur?" Thashë, "11 mars". Aaaa {onomotope} ai ka ofshae niherë edhe ka shajhtë. Tha, "Ku ja qëlllove datën me 11 mars me lindë". "Po", thashë, "më 11 mars". Une s'kom qëllu në Prishtinë, pastaj po them jam njohur me të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur edhe në Prizren edhe në Ferizaj edhe në Prishtinë, ngjarjet. Por unë aktiv nuk kam qenë në ato ngjarje, sepse synimin e kam pasë me formu grupin tonë edhe e kemi formu nëpërmes grupit me veprue. Kjo ishte.

Ato thujase të gjitha ishin stimulim nga ana jonë për me kriju dishka, m'u rebelu njerëzit, edhe u rebelun njerëzit, u arrit qëllimi domethanë. Ngjarjet e 11 marsit, ngjarjet e 25, 26, 1, 2, 3 prill e ren, ishte iniciativë e '68-tës. Baba i grues edhe ata kanë qenë filli, që lulet e para të ngjarjeve, domethanë revolucionare. Edhe na pastaj e kemi vazhdu njëfarë rrjeti prej tyne, po pas neve kanë vazhdu edhe shumë të tjerë gjenerata, deri sa u arritë qëllimi. Ishte qëllimi me u arritë qëllimi me pasë një kryengritje madhore popullore, me u vetëdijesu populli që na nuk pajtohem me këtë politikë. Edhe u pajtue.

Ishte shumë problem sepse ata e kuptonin që unë me babën tim ishim pak ma të rebelum edhe kërkonin me organizue mbledhje në shtëpinë tonë, për me ra në kurth. Edhe tash po thotë baba, "Bre bir, çka do të bëjmë?" Tha, "Synimin e kanë me na qitë neve në kurth". Thashë, "Ti mos u mërzi, duhet të organizohemi edhe këtu do të mbajmë mbledhje, nuk është problem. Le të vinë ata, ne do t'i presim ata, do t'i përcjellmi edhe secili ta shprehë mendimin e vet, ta shohim ku janë ata". "Po ti çka do të thu?" "Unë s'jam në gjendje", thojke, "m'i dënu une gjeneratën", demonstratat. "S'muj unë në shtëpinë time", thojke, "me pranë një gja të tillë edhe m'u nënshtru, me thanë që une i dënoj demonstratat e '81-shit". "Jo, jo, jo, jo, s'ban, e pamundur është".

Po se si u arritë ajo [mbledhja], jo me u mbajtë në shtëpinë tonë, po me u mbajtë në shkollë edhe u mbyll ai kapitull. Kështu që, ne shpëtum, na vazhdum aktivitetin tonë. Baba ka qenë i pathyeshëm edhe ai, nuk është përkulë, edhe ai ka qenë nja dy herë i burgosun, po nga dy muj për kundërvajtje, pse është dorëzue. Nji kohë të madhe të ngjarjeve të '90-tës, ka pasë ngjarje të mëdhaja këtu në Arbanë edhe në Zhur, në këto dy qendra ka pasë organizime ma të forta. Në shumë vende ne kemi arritë me organizu shumë mirë edhe m'i tërheqë në momentet ma kritike, m'i tërheqë masën, sepse dy u patën vra në Arbanë.

Kemi arritë me tërheqë masën se patën fillu policia me gjujtë pamëshirshëm, gjujshin. E une nga përvoja, e organizojsha me marr qepë edhe me ju çu demonstruesve m'i fërku [sytë], ata ishin të pa informum se si me qepë kalohet ai tymi i barutit. Po edhe kështu që e patën kalue, shpesh herë më janë falënderue që arritën nëpërmes meje domethanë me pshtu prej asaj gjendje. Po edhe kemi pasë

ndihma prej policëve shqiparë. Të them të vërtetën, disa prej tyre kanë pasë merita, s'du t'i përmendi se nuk është mirë m'i përmend me emra, ata që kanë bo keq, po ata që kanë bo mire, nuk o problem.

Prej tyre ka pasë disa policë që paraprakisht na lajmërojnë, "Deri në momentin kur ne ju themi vazhdoni, ngriteni zërin, brohoritni, gjuni dhe kur t'iu themi tërhiq, tërhiq se nuk është në rregull". Se ata merrshin informata që po vinë forca speciale edhe thashë, "Pse me pësu ne?" Kështu që e kalojshim situatën edhe kemi pasë ka pak prej tyre ndihmë, disa nga policët të asaj kohe.

Anita Susuri: Vitet e '90-ta qysh kanë qenë për juve, t'u e pasë parasysh që keni qenë ish i burgosur e keni qenë në sy?

Nuhi Bytyqi: Po shiqo, unë e kam edhe një farë dosje se unë s'e kam ditë që kam qenë i përcjellun, e e kom gjetë prej arkivës, ma kanë dorëzue që ky ka qenë i përcjellun. Unë s'e kam ditë. Po, nuk ka pushu aktiviteti. Të tregova që synimi ka qenë deri në fund me çu kauzën, jo me ndërpre. Edhe ne vazhdum, e formum grupin në mënyrë ilegale. Une vazhdojsha me shku në mbledhje të formimit të atëhershëm të LDK-së, si maskim. A knej ne organizojshim edhe organizime në mënyrë ilegale për me formue një ushtri, sepse filloi iniciativa. E une maskohesha nëpërmes partisë një kohë, derisa drejtën me thënë, nuk më pëlqyn veprimet e tyre, sepse ta imponojshin si duhet veprue.

Partia me ma imponu mue si duhet veprue edhe unë u tërhoqa. U tërhoqa prej saj. Vazhdova në mënyrë ilegale, thashë të mirrem kapak me formimin e ushtrisë, po punojsha ka pak tregti, maskim. Punojsha tregti, shkojsha mirrsha mall e u bojsha kinse s'po di edhe knej na morëm informata se është zbulu grupi edhe, "Pse nuk po ikni?" Po thashë, "Kurrë nuk ka qenë qëllimi im me ikë, me lëshu Kosovën për një vjet, dy vjet, dhjetë vjet, 15 vjet burg. Do të qëndroj këtu edhe ta shof situatën".

Edhe kështu që, pavarësisht që ka pasë, ne kemi kundërshtu në forma të ndryshme, kur u bo, kur e morën këtë autonominë, po u organizu atëherë në mënyrë partiake me kundërshtue. Po s'ishte ajo kundërshtim pa u formu diçka, do qelula për me ngritë zërin edhe për me i dhanë njëfarë drohe [frikë] Serbisë që edhe ne kemi diçka që mund të hakmirremi. Forma të ndryshme, a me pushkë, a me revole a me diçka, me dalë kundër tyre. Po të them të vërtetën u zbulum, u zbuluam edhe ramë në kurth. Ramë në burg, vujtëm burgun. Deshi fati u formue ushtria.

Shiqo, sepse fillet e UÇK-së janë te ne, te ne. Po them, ndash pranoje, ndash jo. Adem De... ky, Adem Jashari ka qenë në grupin konstituiv të frontit. Domethanë edhe qysh atëherë është tërheqë, ka kalue në Shqipëri edhe kanë formue grupet e veta me mujtë me ushtrue, sepse synimi i tij ka qenë formimi i grupeve, formimi i ushtrisë edhe me dalë me luftue. Na ramë në burg, ata kanë vazhdue me prue edhe u arritë qëllimi pastaj, prej njerëzve që e kanë dashtë atdheun, e kanë dashtë shtetin, edhe vdiqën ata qysh e lypën, domethanë për çashtje kombëtare dhanë familjen. Eeej, familjenm çka do me thanë me dhanë për çashtje kombëtare?

Anita Susuri: Qysh i keni përjetu ju këto për shembull, '98-tën veç kanë qenë domethanë vrasja e familjes Jashari, pastaj atje në Qirez që ndodhën ato vrasjet. Veç është vrejtë që po fillon luftë...

Nuhi Bytyqi: Jo, jo, ne e dishim që lufta ishte hap pas hapi. Une kam qenë i ftuar në Reti për me organizu me udhëheqë për çështje të moralit. Po, thashë, u dashtë me qëndru një kohë këtu, shkova në Prishtinë. Ika unë këtu se u zbulova, u zbulova këtu, ika tinza me gruan, shkuam në Prishtinë.

Qëndrova disa ditë në Prishtinë, pastaj në mënyrë ilegale kam kaluar nga Prevala, kemi ardhë në shpi. Edhe këtu kam qenë një kohë i mshefun, edhe t'u mendu me u organizue edhe me dalë në front. Po bona nifare rrokade, thashë rreth ndërtimit të qëtij objektit, e vllau im u angazhu pastaj në UÇK.

U tërhoqën, shkun në Drenovc për me u organizue, për me ushtrue. Janë ushtrue atje edhe pastaj u ndanë për qendra të ndryshme, dikush në Prizren, dikush në Malishevë e dikush anej edhe filloi xixat e para të ushtrisë. Na të drejtën me thanë i dishim pasojat, por edhe ndjejmë në vetvete njëfarë gzimi që diçka po do me ndodhë. Nuk ishte mirë me e futë masën në atë flakë, po diçka duhej m'u bo. Nuk shkonte ashtu jeta, gjithmonë nër thundrat e Serbisë me u nënshtrue.

“Do të vdesin, do të vdesin”, dikush ka pasë fatin me vdekë, dikush jo. Por ja që une sot jam gjallë, po jo i aktivizim në UÇK. Më vjen keq po, rrethanat kanë qenë asisoji që une nuk jam shkue. Kemi qenë na nëpër shtaba, kam qenë me gjithë gruen në shtab në Suharekë. Kemi vizitu ata, kemi kqyrë situatën si shkon, po edhe kemi pasë direktiva me vazhdu me punu këtu. Secili e ka pasë atë rolin e vet çka me bo.

Anita Susuri: E luftën qysh e keni përjetu? A ka pasë këtu rrezik?

Nuhi Bytyqi: Ka pasë, ka pasë. Ka pasë edhe këtu xixa të luftës, xixa të kundërshtimit, se kjo pjesa e Arbanës është pjesa ma e rebelume. Kjo po them edhe Zhuri, që kurrë nuk janë dorëzue. Këtu kanë vdekë dy djem edhe një pjesë e tyre kanë qenë të plagosun, nuk janë dorëzue kurrë. Na kemi heroin tonë Ismajl Kryeziun, kemi shumë heronj tjerë që kanë vdekë për çështje kombëtare, kanë dhanë kontributin e tyre.

Po mos të thom që kanë qenë, ndoshta stimulus ne kemi qenë, po ata kanë qenë që nuk janë dorëzue, domethanë kanë vazhdue. Kanë vazhdue edhe kanë dhanë jetën e tyre. Njerëzit kanë vdekë në momente kur janë, kur i kanë tërheqë. Gruja harroi me thanë që neve kur na kanë ndal, kjo nuk o dorëzue. Tha, “Jo”, tha, “edhe na do të vdesim”. Se i tha, “Tërhiquni ju”, domethanë pra tërhiquni, ecni, e neve ja me na çue në burg, ja...

Anita Susuri: Policia ju kanë nalë?

Nuhi Bytyqi: Po, po, policia. Me çelë rova, sene, i çojshin rininë. Po kjo e diti që unë isha në shënjestër. E tash si tha, “Jo edhe unë do të qëndroj këtu me fëmi, do të flijojmë bashkë”, ju bashkangjiti edhe kunata, se edhe ajo ka qenë e burgosur. Edhe e panë situatën, intervenoi dikush prej andej, tha, “Pusti, lëshoji, mos krijto tollovi”. Nafaka na lëshun. Si në formë i mshehun une ka pak, depërtim edhe arritëm në Shqipëri atje. Pastaj, një pjesë, ju nashta jeni të reja, po një pjesë e dinë sa, çka ka pasë... ne vllaun e kemi pasë në front, çdo moment pritshim kur vjen informata, po pshtoi, edhe ai edhe shumë të tjerë kanë shpëtue.

Anita Susuri: Keni pasë kontakte me vëllaun?

Nuhi Bytyqi: Jo, jo, jo, jo.

Anita Susuri: Kur u kon kontakti i parë që e keni bo me të, që e dini që ka qenë gjallë?

Nuhi Bytyqi: Jo, vike me u pastrue prej pikës këtu në Vvri, vike kajherë. Bile, a më beson që një pjesë e madhe e fqinjëve thojshin, “Pse pe lejoni me hy mbrenda?” E baba s’ka pasë frikë hiç, “Nëse doni ju me ardhë këtu, urrnoni. Nëse s’doni, shkoni nëpër shpija të juja. Ky o djali im, ka ardhë te une”. Edhe na e mirëpritshim edhe s’kishim çka me bo se vlla e kisha unë, e ai e kishte djalë. Po ata tinza e përcillshim përsëri. Në mëngjes heret shkojke u angazhojke atje, ose në momentin e fundit kur i ka ra Vrrinit, jemi detyrue m’i qitë në Shqipëri. Edhe une e kom organizue një makinë edhe i ka qitë disa në mënyrë ilegale, kanë dalë për Shqipëri edhe atje kanë vazhdue punën.

Anita Susuri: Sa keni qëndru në Shqipëri?

Nuhi Bytyqi: Po qat periudhë deri në qershor, deri në qershor. Ne arritëm atje, unë drejtë të them e kisha nën mbikqyrje ma tepër çashtjen e familjes se baba ishte i vjetër e unë ka pak me familje. Por merrshim na informata, nëse duhej me u bashkangjitë nuk ish problem. Po dulën pastaj Forcat Ndërkombëtare edhe u arrit qëllimi. Më tregoi pak, baba im ka qenë i pari nismëtar që ka hy këtu pastaj me NATO-n, mejherë pas NATO-s. Nuk mujta me përballue unë pastaj mas dy dite kom ardhë. Une pastaj ton kohën 1999 mas qershorit kom qenë organizator i ngjarjeve për të pagjeturit. Krejt ngjarjet shka janë zhvillue në Prizren, nëpërmes meje janë organizu.

Janë bashkangjitë pastaj partitë politike, Zafiri e këta, prej tyne. A une përndryshe kam qenë organizator i atyre ngjarjeve derisa edhe komuna e pa, se shkojsha nëpër institucione, në spital, në ambullantë, nëpër fabrika, i tërhiqsha punëtorët, i organizojsha me dalë, me dalë në protesta, sepse duhet m’i gjetë këta njerëz që janë zhdukë. Nuk e arritëm qëllimin m’i gjetë një pjesë të madhe prej tyne, po derisa, të them të vërtetën, e panë edhe ata, komuna, se në komunë shkojsha. Thojsha, “Ju duhet të jeni të parët, ata që duhet m’u ngritë, me ngritë zërin”, edhe më kapën më çunë mu pak, më emërun si njëfarë lloj drejtori me një ndërmarrje shoqërore, “Lidhja e Shoferëve”, për ngasës, shoferë.

Qaty, po unë përsëri kam qenë i pandalshëm. Nuk u ndala edhe kam vazhdu derisa u mor pastaj në mënyrë institucionale organizimi i të pagjeturve. Edhe këtu në shoqatë pastaj u bënë ndryshime pak, unë u tërhoqa, lshova një pjese tjetër me udhëheqë shoqatën, sepse ton kohën unë, në atë kohë kur ka qenë ma kritike, u duke m’i hypë autobusit me shku në Prishtinë, me u taku me Shoqatën e të Burgosurve, me marrë direktiva edhe çka duhet bo këtu. Edhe në atë periudhë kohore unë kam shkepë shumë, shumë ndihma familjeve të të burgosurve, familjeve të varfëra.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë a ka pasë naj organizim për lirim e të burgosurve politikë, se edhe pas luftës ka pasë shumë që janë mbajtë në Serbi?

Nuhi Bytyqi: Na kemi kërkuë, kauza jonë ka qenë me kërkuë lirim e të burgosurve politikë. Ndër ta u liru Albin Kurti edhe një grup tjetër i madh u liru. Po a ka qenë iniciativa jonë apo ka qenë e politikës ndërkombëtare, na nuk e dimë. Po na s’ju kemi ndalë asaj pune, domethanë kemi vazhdu në mënyrë të parreshtur me kërku lirim e të burgosurve politikë. Na edhe sot jemi skeptikë se ai nuk ekziston, Ukshin Hoti. Po na s’dimë, na duhet me kërku deri në moment të fundit, ja eshnat, ja njeriun me sjellë në Kosovë. Po s’ka ndikim edhe politika jonë, kështu që nuk ia shoh për të madhe politikës sonë pse nuk kanë ndikim, sepse Serbia nuk dorëzohet. Na e dimë kush o Serbia.

Mu më duket absurde kur thojnë Serbia duhet me pranu Kosovën. Serbia kurrë s’ka me pranu Kosovën. Po na duhet me punue pa ndalë, duhet me punu shumë për me arritë diçka. Duhet me punu

shumë. Thojnë, “Një filxhan shkencë, një shishe respekt edhe një liqen durim”. Na duhet shumë me punue për me arritë shtetin tonë me pasë të fortë, që pjesa e rinisë mos me ikë nga Kosova po me qëndru në Kosovë. Mjerisht që nuk e kanë këtë vullnet politikanët tanë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë veç për përjetimin e pavarësisë, se osht’ ajo që...

Nuhi Bytyqi: Po ai ka qenë synimi ynë, ka qenë synimi ynë ai dhe u realizue. Na e kemi pritë me gëzim të madh atë ditë, na kemi qajhtë një pjesë e madhe për atë ditë. Kemi qa pa u ndalë, s’kemi ditë m’u ndalë prej gëzimit. Por u arrit ajo shumë mirë. Nuk po dinë me punu politikajtë tanë. Pavarësia u arritë. Merre me mend, deshën s’deshën me pranë Serbia e një pjesë e shteteve të Europës, na jemi shtet. Na duhet m’i çelë sytë me punu shumë. Duhet shumë me punue, me ulë kokën edhe me punu, me krijue, me ofrue për gjeneratën e re vende të punës edhe me vazhdue me jetue. Mos m’u dorëzu na [për shkak të] prej qëllimeve të këqija të Serbisë, presioneve të serbëve. Na s’duhet me i kqyrë ata, na duhet me punu shumë.

Unë i kam ba vitet tash, s’muj mu angazhue. Le që s’muj, po as nuk lypin këshillë prej meje. Se tash, kanë qëllu nashta ma të mëçëm. Po askush nuk ka arritë me ardhë me lypë këshillë, me thanë, “O baci Nuh, po a na ofron diçka, a men a këshilla?” Po jo, po vazhdojnë me të veten edhe kështu që une jom tërheq me ka krejt. Kom qenë pak aktiv nëpër partitë politike, jom tërheq me ka krejt edhe po rri në shpi. E kam një vend qatje, e kam një vend nja pesë ari, një kopsht. Kam lulishte, pemë, perime, e humbi një kohë të mirë atje e nuk shkoj diku tjetër me hup kohën.

Une nuk e di ku është çerdhja e pensionerëve, domethanë që thojnë Shtëpia e Pensionerëve, nuk shkoj atje me humb kohën sepse kam ku e humbi kohën. Kënaqem atje, me atë çka kam kriju atje me durt e mia. T’u iu falënderu edhe zojës, sepse thujase kontributi i zonjës sime është ai vend edhe unë atje e humbi kohën edhe e kaloj kohën shumë bukur dhe ndjem shumë i fuqishëm, në krahasim me gjenratën time. Kam një pjesë të madhe të shokëve që kemi qenë në atë kohë nëpër burgje, shumica janë dërmue, janë lodhë. Pse? T’u marrë ma tepër me politikë. Nuk ju lypë kush këshilla, po e mendojnë veten.

A ju them diçka të vërtetën? Kurrë nuk i përcjelli këto debatet politike. S’kam nevojë m’i përcjellë sepse ajo o një mendim i njënit prej tyre. Nuk o një vendim që po zbatohet. Një mendim. Kështu që nuk i përcjelli. Kqyri aty këtu filma edhe kaloj këtë kohë me zojën time, me nipa, mbesa. Vijnë, më vizitojnë ka pak. Janë të martume vajzat, po vijnë më vizitojnë shpesh mu e zojën, kështu që knaqemi me ta.

Anita Susuri: Zoti Nuhi nëse doni edhe diçka me shtu për fund ose që ki harru...

Nuhi Bytyqi: Jo, s’kam çka me thanë. Por une pak përpara thashë që, ndoshta ka qenë turp me thanë, a di që na kanë rrahë. Po na kanë rrahë edhe aspak nuk ka qenë turp sepse atë që kemi lypë e kemi ditë që do të ndodhë. Ukshin Hoti thoshte në fund, “Kemi bo një gabim”, thojke, “kolektiv”. “Hë, bac?” Se ne e thirrshim bac. Ai neve bac, na atij bac. “U dashtë në mënyrë kolektive mu çu krejt me u dorëzu në burg e me thanë na jemi për qet kauzë, edhe ju nëse doni, mirë, nëse s’doni, na ja ku jemi këtu”. Jo me u tërheq, sepse ka qenë një farë dobësie e jonja, e shumicës së grupeve ilegale që mos me tregu emra, m’i mbajtë sekret.

A po don me u realizu qëllimi, kauza? Hec përpara, çaje rrugën. Po nuk bohet në burg. Po në burg arrihet, sepse një pjesë e madhe e shoqatave ndërkombëtare, kjo e të drejtave të njeriut, kanë ardhë na kanë vizitu atje edhe janë njoftë me gjendjen tonë. Edhe janë njoftë nëpërmes atyne, kuptohet, nëpërmjet atyne shoqatave ka ba jehonë edhe kauza jonë kombëtare. Sepse janë njoftë me torturat tonë që kemi përjetu në burgje edhe u arritë qëllimi se kosovarët janë maltretue për një kauzë edhe atyne duhet me ju dhanë të drejtë më në fund. Kjo desha me thanë, që Ukshin Hoti e ka pasë shumë mirë, që ne u dashtë në mënyrë kolektive me veprue.

Po u arritë, përsëri u arritë, përmes UÇK-së që ne duhet të jemi falënderues, një pjesë e madhe. Mue po më pëlqen kjo nisma ju, sepse zbulohet diçka. Po duhet me ekzistë edhe një nismë tjetër si ju apo ju, m'i mbledhë shënimet për ish-luftëtarët. Edhe taman m'u zbulue, sepse kot e ka me rrejtë dikush që ka qenë në luftë, sepse munet m'u zanë. Shumë lehtë zinet ai i cili nuk ka qenë aktiv në luftë, se nuk o lehtë me gënje. Tash, sot kanë dalë shumë mjete moderne që zbulojnë a p'e flet të vërtetën apo po rren edhe bjen në kurth. Kjo duhet me ekzistë ma tepër nëpërmes të kësaj grupit të UÇK-së, me u zbulu njerëzit e vërtetë të cilët kanë dhanë kontribut edhe kanë luftue.

E një pjesë e tyre janë vërtetë fallc, na e dimë që janë një grup i madh të fallsifikum, po zbuloji. Kjo nisma ju më pëlqej pak. Nuk pranoj une me fol për jetën time, por nismë e mirë, sepse po i mbledhni shënimet taman për ata që kanë vuajtë, për ata që kanë qenë nëpër burgje. A do të jenë dosje, a do të jenë dosje, nuk është me rëndësi... po mu po më thërret një shoqe, tha kjo drejtoresha. Motra e drejtoreshës po më thërret, tha, "Nuhi e kam një dokument tëndin", që unë kam qenë i përcjellur. E une s'e kam ditë që kam qenë i përcjellun. Domethanë, po ma mirë që s'e kom ditë se kom veprue ashtu.

E me pasë ditë u dashtë pak m'u masku, m'u mshefë e tinza me dalë. E une kom dalë edhe të them të vërtetën i kom pa policinë e kom grisë letrat. Nëse s'i kom përbie, i kom grisë, ia kom shti flakën. "Šta je bilo?" [Çka u bë?] "Upalio sam cigaru" [E ndeza cigaren]. "E kam dhezë një cigare" edhe asi, ai s'e dike. Po kanë kalu ato, kanë qenë momente... Une po të them, kam qenë në burg, një periudhë kohore shtatë vite, po aq momente të kandshme kam me shoqni, aq momente të bukura. Ne shpesh herë takohemi me shoqni, diskutojmë, debatojmë, krejt shoqnia janë nëpër parti të ndryshme, po qëllimi është i përbashkët. Domethanë, ne takohemi edhe e lëmë çështjen politike anash edhe diskutojmë për jetën qysh e kemi kalu në burg.

Edhe aq bukur kalojmë me shoqni, sa shpesh herë çuditën. Ajo grua jeme bile çuditet, thotë, "Qysh, që aq i lirë je". Po jam i lirë sepse me ta kemi nejtë, kemi hongër dajak. Thashë, "Ne kemi hongër dajak edhe kemi kemi fërkue, njani-tjetrit ia kemi fërkë shpinën kur kemi shku në banjo". S'na ka ardhë keq. Për çdo gjë i kemi ndihmu shoqnisë, sepse ka qenë një qëllim i mirë, një qëllim i pastër, një qëllim kombëtar. Edhe një pjesë e mirë e tyre vazhdojnë. Mu më vjen shpesh herë, mos të them inati, sepse një pjesë e madhe e mërgatës janë shumë ma patriotë se na. Shumë ma shumë se na po e ruajnë traditën kombëtare, me kangë folklorike, popullore. Dinë një pjesë e madhe e asaj rinie m'i ra veglave, nashta e keni vërejtë ju, veglave, këndojnë shqip. Ajo o kënaqësia ma e madhe.

Pastaj, kontributi i mërgatës është i pazëvendësueshëm. Na nuk guxojmë me folë keq për ta. Ata janë shpëtimi ynë, sepse na jemi pa punëtorë në Kosovë. Ata po e mbajnë Kosovën. Na kot e kemi, gërrnaça e... ata janë shpëtimi i Kosovës. Na duhet m'u mburrë me ta. Faleminderit që keni gjetë kohë, më keni intervistue, ndoshta kemi lanë diçka mangi, po këto që e thashë, është pjesa dërrmuese, është pjesa ma e madhe e jetës sime. Une gëzohem që jam gjallë, gëzohem që e kam një familje të mirë edhe

gëzohem që sot po e kaloj jetën kështu si po e kaloj. Jo i pasun, hiç i pasun, po edhe jo i varfër, po shumë i kënaqun me familjen time.

E kam një djalë, tri çika. E ka gjetë fatin e vet djali. Unë jam me një ditëlindje me djalin, më 11 mars. Po ja, jam i lumtur, shumë jam i lumtur. Kështu që, ajo më ka mbajtur, ai elan i lumturisë sime, ndaj zonjës time, ndaj vajzave, djalit, nipave e mbesave. Unë jam shumë i lumtur që sot e kam këtë forcë, këtë fuqi në jetën time, në shëndetin tim. Unë e kam shëndetin e mirë edhe nuk dorëzohem. Faleminderit prej juve!

Anita Susuri: Faleminderit shumë juve, ishte kënaqësi.